



FEDERATA E TENISIT E KOSOVËS
TENISKA FEDERACIJA KOSOVA
KOSOVO TENNIS FEDERATION

Kosova Tennis Federation
House of sports
Agim Ramadani str,
10000 Prishtina
Kosovo
T: +383 45 746 543
www.tenniskosova.com

**RREGULLORE NR. #11
PËR
PUNËN E KËSHILLIT MBIKQYRËS TË FEDERATËS SË
TENISIT TË KOSOVËS**

Prishtinë, 2022



Në bazë të Statutit të Federatës së Tenisit të Kosovës neni 9, paragrafi 9.3, Kuvendi i Federatës së Tenisit të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm ‘Kuvendi’), në mbledhjen e vetë të mbajtur më Nëntor 2022 në Prishtinë, miratoi këtë:

RREGULLORE PËR PUNËN E KËSHILLIT MBIKQYRËS TË FEDERATËS SË TENISIT TË KOSOVËS

Neni 1

Qëllimi

Përcaktimi i rregullave të punës së Këshillit Mbikëqyrës të Federatës së Tenisit të Kosovës që prioritet do të ketë mbikëqyrjen e punës së Bordit, Kryetarit dhe organeve tjera të FTKsë.

Neni 2

Veprimtaria

Këshilli Mbikëqyrës punën dhe veprimtarinë e tij e bazon mbi parimin e ligjit, statutit të FTK-së dhe kësaj rregulloreje. Këshilli mbikëqyrës përcjell ligjshmërinë punës së Bordit, organeve dhe trupave të tjerë të FTK në mes të dy Kuvendeve dhe mbikëqyr afarizmin financiar të Federatës.

Neni 3

Vendimarrja

- 3.1. Këshilli Mbikëqyrës prej tre (3) anëtarëve vendosë me shumicë votash për vendimet e tij.
- 3.2. Bordi dhe të gjitha trupat e tij janë të obliguara që Këshillit mbikëqyrës të i mundësojnë mbikëqyrjen në punën e tyre.
- 3.3. Këshilli mbikëqyrës takohet së paku çdo gjashtë (6) muaj.
- 3.4. Këshilli Mbikëqyrës për çdo takim duhet që të përpilon raport me shkrim i cili duhet që të jetë i përcaktuar në detaje dhe me pas i njejt i dërgohet Kuvendit të FTKsë.
- 3.5. Çdo dokument në Këshillin Mbikëqyrës duhet që të trajtohet sipas legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, ruajtjes së dokumenteve dhe arkivimit të tyre.



Neni 4

Bashkëpunimi

Çdo organ i FTK-së është i obliguar që Këshillit Mbikëqyrës, t'i mundësojnë çasjen në të gjitha dokumentet e FTK të kërkuara në Këshilli Mbikëqyrës.

Neni 5

Raportimi

Këshilli Mbikëqyrës për punën e vet i raporton Kuvendit të FTK-së në baza vjetore.

Neni 6

Zgjedhja e anëtarëve dhe kryesuesit

6.1. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës i zgjedh Kuvendi i FTK-së me mandat të rregulltë katër vjeçar, me të drejtë të rizgjedhjes edhe për një mandat. Anëtari i Këshillit nuk mund të jetë anëtar i organeve dhe trupave të tjera të Federatës.

6.2. Anëtarët e zgjedhur të këshillit, e zgjedhin Kryesuesin me shumicë votash.

Neni 7

Të drejtat dhe detyrat e kryesuesit

Kryesuesi i Këshillit Mbikëqyrës ka të drejtat dhe detyrat si vijon:

- 7.1. Organizon mbledhjen e Këshillit Mbikëqyrës,
- 7.2. Kryeson me mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës,
- 7.3. Kujdeset për sigurimin e transparencës në punën e Këshillit Mbikëqyrës,
- 7.4. Kryen edhe detyra të tjera të caktuara me Rregulloren mbi Punën e Këshillit Mbikëqyrës.

Neni 8

Të drejtat dhe detyrat e anëtarëve

Anëtari i Këshillit Mbikëqyrës ka këto të drejta:

- 8.1. Propozon shqyrtimin e pyetjeve nga fushëveprimi i punës të Këshillit Mbikëqyrës.
- 8.2. Shtron pyetje dhe kërkon sqarimin për çdo pikë të rendit të ditës në mbledhjen e Këshillit Mbikëqyrës



8.3. Paraqet propozime lidhur me vendimet, raportet, konkluzionet dhe aktet tjera nga fushëveprimi i punës së Këshillit Mbikëqyrës.

Neni 9

Caktimi i mbledhjeve dhe rendi i ditës

Mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës i cakton:

9.1 Kryesuesi i Këshillit Mbikëqyrës,

9.2. Dy (2) anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës.

9.3. Rendin e ditës e përcakton caktuesi i mbledhjes.

9.4 Secili anëtar mundë të propozoj edhe ndonjë pikë të rendit të ditës para fillimit të mbledhjes duke e dërguar me shkrim në formë elektronike të gjithë anëtarëve të Këshillit.

Neni 10

Procesverbali

10.1. Në mbledhje të këshillit Mbikëqyrës mbahet procesverbali, i cili duhet të pasqyrojë rrjedhën e mbledhjes dhe vendimet / konkluzionet e aprovuara.



10.2. Procesverbalin duhet ta nënshkruajnë Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës.

Neni 11

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hynë në fuqi ditën e miratimit.

Kryetari i FTK-së
Jeton Hadërgjonaj



17 Nëntor, 2022